



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 40 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar për lëndën e formuar pas denoncimit nga parashtruesi ..... dorëzuar der tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

### VENDIM

Denoncimi i dorëzuar me datë 15.10.2019, parashtruar nga parashtruesi ..... deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të së cilës është e formuar lënda 12-4819/1 me datë 15.10.2019, në të cilën flitet për akuza për dyshime të veprimeve joligjore të gjyqtarit ....., ish gjyqtar në Gjykatën themelore Shkupi II në Shkup, gjatë rrjedhës së procedurës gjyqësore dhe miratimin e Aktgjykimit me datë 11.07.2011 me të cilën kontrata e nënshkruar paraprakisht për dhuratë është shpallur si asgjësim dhe parashtruesi i denoncimit është obliguar t'ia jep në qeverisje shtëpinë e cila gjendet në rr. Ho Sh Min nr. 111-b vëllaut të tij, **RREFUZOHET**.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-4819 nga viti 2019.

Lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi të dorëzohet Vendimi i KSHPK me sqarimin

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

### SQARIM

Lënda me numër 12-4819 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nga parashtruesi .....

Në denoncim flitet për akuza për veprim joligjor të gjyqtarit ....., gjyqtarë në Gjykatën themelore Shkupi II në Shkup (këtij gjyqtari i është vërtetuar ndërprerje e funksionit të gjyqtarit përshkak të plotësimit të kushteve për pension të moshës me datë 28.06.2008) në procedurë gjyqësore në bazë juridike vërtetim të asgjësimit të kontratës për dhuratë, të cilën e ka precesuar në vitin 2001. Në këtë procedurë gjyqtari ka miratuar Aktgjykim me datë 11.07.2001 me të cilën kontratën për dhuratë nënshkruar ndërmjet babait të parashtruesit të denoncimit dhe parashtruesit e ka shpallur si të pavlevshëm dhe parashtruesi ka qenë i obliguar që shtëpinë e cila gjendet në rrugën ..... t'ia jep në qeverisje dhe ti'a pranon të drejtën e shfrytëzimit të objektit të rastit vëllaut të tij. Në denoncim shprehet pakënaqësi për veprimin e gjyqtarit të lëndës, të cilit i është përfunduar kryerja e funksionit të gjyqtarit në vitin 2008.

Pas shqyrtimit tē akuzave qē gjenden nē denoncimin dhe dokumentat shoqēruese, Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit vlerēson se denoncimi nuk pērmbanē elemente tē cilat tregojnē pēr korrupsioni – keqpērdorim tē funksionit, autorizimit publik, detyrēs zyrtare ose pozitēs pēr realizimin e interesave, drejtpērdrejtē ose me ndērmjetēsues, pēr vete ose pēr tjetēr. Njēherit, denoncimi i lēndēs nuk udhēzon nē veprim korruptiv tē personave zyrtar – tē zgjedhur, tē emēruar ose qē kryejn punē tē karakterit publik, as indicje qē veprimet e pērmendura mund tē ojn nē bazē pēr dyshim pēr kryerje tē veprēs penale nga Kreu i tredhjetē – vepra penale kundēr detyrēs zyrtare nga Kodi penal i Republikē sē Maqedonisē.

Duke pasē parasysh tē theksuarēn mē sipēr, Komision shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit, vendosi sipas dispozitave tē kētij vendimi.

**KOMISIONI SHTETĒROР ПЃР  
PARANDALIM TĒ KORRUPTIONIT  
Zēvendēs-Kryetarē: m-r Shemshi Sallai**

Pas pērfundimit tē KSHPK  
Pērpunoi: m-r I. P.  
Miratoi: N. B., anētar i KSHPK

